

JULIAN QAMO

SINTAGMATIKA ILUSTRUESE NË LEKSIKOGRAFI

Në një zë leksikografik në fjalor ndeshet dhe sintagmatika e cila është dy llojeshe:

a. *Sintagmatikë shpjeguese*, që nënkupton linearitetin e shpjegimit të kuptimit të një fjalë njëkuptimëshe dhe të kuptimeve të një fjalë shumëkuptimëshe. Në shpjegimin kuptimor ka një organizim taksonimik shkencor të përbërësve kuptimorë. Le të marrim për shembull fjalën *dardhë* në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe*, 1980: në kuptimin e parë, themeloret, fillimisht tregohet gjinia (dru frutor), pastaj, meqenëse është dru gjetherënës, jepet informacion për gjethet, i ndjekur nga informacioni për lulet të cilat në fund lidhin kokrra. Po kështu në sintagmatikën e njëjësive frazeologjike, njësitë nuk vendosen rastësisht, por sipas rendit alfabetik: **dárdh/ë, ~a f. sh. ~a, ~at** edhe **~ë, ~ët. 1.** Dru frutor me gjethë gjatoshë e të ndritshme e me lule të bardha, që bën kokrra të tulta e të ëmbla, të zgjatura nga bishti e zakonisht me ngjyrë të verdhë kur piqen; kokrra e kësaj peme. *Dardhë e butë. Dardhë e egër* gorricë. *Dardhë bishtje* dardhë me bisht të zgjatur. *Dardhë bulbe. Dardhë elbje* dardhë që piqet në një kohë me elbin. *Dardhë brumje* dardhë që kur piqet, bëhet e butë si brumë. *Dardhë dimërore (dimërake)* dardhë që piqet vonë, nga fundi i nëntorit ose që lihet për t'u ndulkur në dimër. *Dardhë gurje* dardhë me tul të fortë. *Dardhë mbytje. Një kokërr dardhë.* * **Ka rënë në dardhë dikush** ka zënë ngushtë, është zënë ngushtë, është në hall. **I doli dardhë diçka** nuk i doli mirë një punë, nuk i doli ashtu siç e parashikonte, i doli me e vështirë nga ç'mendonte; nuk i eci. **Do t'i dalin dardhat dikujt** do t'i dalin në shesh dallaveret që ka bërë, do t'i dalin të palarat. **Do ta hajë dardhën dikush shih te HA.** **Është rrëzuar (një herë) nga dardha dikush** e ka pësuar një herë dhe ka vënë mend, është qen i rrahur; ka përvojë nga jeta, është i rrahur me jetën. **Dardha në shënëndre** gjepura, pallavra, punë boshe. **S'bëjnë dardhat në shënëndre** është e pamundur të bëhet a të ndodhë diçka, nuk ka mundësi të ngjasë; çdo punë do kohën e vet dhe kushtet e nevojshme. **Kërkon dardha** (thana, **thanëza, rrush**) **në shënëndre (në dimër)** kërkon të pamundurën, kërkon qiçra në hell. **E shpunë (e çuan)**

dardhë u zunë njëri me tjetrin, bënë fjalë, u grindën; i keqësuan, i ashpërsuan marrëdhëniet. **Dardha nën dardhë bie** një njeri do t'u ngajë pa tjetër të parëve të tij, vetitë e cilësitë e prindit do të shfaqen edhe te fëmijët. **Kërkon dardha nga boriga** *shih te BORIG/Ë ~A*. **Dardha e ka bishtin prapa**, çdo punë, që mund të duket e lehtë e pa telashe, ka edhe pasoja të paparashikuara (zakonisht kur pasojat janë jo të mira). **Është ende në fund të dardhës** është ende prapa, është ende në bisht. **Ai është në rrëzë të dardhës** është pranë të mirave e përfiton prej tyre, është si veshka në mes të dhjamit. **Sillet kot rreth (rreth e qark) dardhës** *dikush* i vjen rrotull me kot dikujt me shpresë se do ta ndihmojë; i hyn kot një pune e shpreson me kot se do të ketë përfitim prej saj. **Kush rri nën dardhë, i ha kokrrat** *fj. u. a)* ai që bën punën, merr edhe shpërblimin; ai që përpiqet për diçka edhe fiton prej saj; b) edhe *iron*, kush rri pranë një njeriu që ka pushtet, pasuri, dituri etj. përfiton me tepër prej tij nga ata që janë larg. **Nuk i hipën dot dardhës e i bie fikut** *fj. u. s'ka ç'i bën gomarit e i bie samarit*. **Pemën, kur s'pjell, e presin se i bën hije dardhës** *fj. u. shih te PEM/Ë,~A*. **Shushunja e dardhës** *zool. shih te SHUSHUNJ/Ë,~A*.

b. Por në një fjalor, njëgjuhësh apo dygjuhësh (por sidomos njëgjuhësh / shpjegues) ne ndeshemi dhe me *sintagmatikën ilustruese*. Në një fjalë / artikull / zë leksikografik në një vepër të tillë jepet shpjegimi i kuptimit, por edhe një numër i caktuar shembuj, thëniesh etj. ku shfaqet minimalisht jeta e fjalës, kuptimi i së cilës shpjegohet. Këta shembuj, thënie etj. krijojnë *sintagmatikën* në kuptimin e ngushtë apo në kuptimin terminologjik leksikografik (term i përdorur në gjuhën shqipe fillimisht nga akademik Jani Thomai¹ dhe më vonë nga studiuesi Hajri Shehu². Ky i fundit përdor dhe termat *shembullsim* dhe *bashkëlidhje leksikore*). Përmes kësaj sintagmatike ilustrohet, saktësohet e plotësohet kuptimi leksikor i një fjale, gjithnjë në vartësi nga lloji, tipi dhe madhësia e fjalorit. Po japim një shembull nga shqipja, nga *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, 1980, fjalën *dorë*, e cila sidomos në kuptimin parë ka me dhjetëra ilustrime që jepen me shkronja të pjerrëta (korsive). **dór/ë,~a f. sh. dúar, dúart**. 1. Secila nga dy gjymtyrët e sipërme të njeriut, që nga supi e deri te gishtat; pjesa e fundit e këtyre gjymtyrëve që nga kyçi, e cila ka pëllëmbën e pesë gishtat dhe shërben për të prekur, për të kapur, për të marrë sendet, për të bërë punë e

¹ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2008, f. 316.

² H. Shehu, *Çështje të sintagmatikës në fjalorë të shqipes*, në Konferencën shkencore ndërkombëtare "Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë", Tiranë, 2005, f. 168.

veprime të tjera. *Dora e djathtë (e majtë). Me duar të mëdha (të vogla, të holla, të trasha, të gjata, të bardha). Me duar të forta (të shkathëta). Me duar të mbledhura grusht. Me duar të lidhura. Me dorë të lirë pa tendosur muskujt e dorës, lirshëm. Me duart plot. Duart lart! urdhër për t'u dorëzuar. Dorë burri dorë e fuqishme. Gishtat e dorës. Pëllëmba (shuplaka) e dorës. Shpina e dorës. Kurrizi i dorës. Qafa e dorës. Kyçi i dorës. Kockat e dorës. Tund (ngre, ul, shtrin, hap, mbyll) dorën. Lau (fshiu, thau, ngrohu, fërkoj) duart. Përplas duart. Shtrin (kryqëzon) duart. Ngre (çon) duart lart. I shtrëngon dorën diku. I puth dorën (duart). I përdredh dorën. I lidh (i zgjidh) duart. I dha (i zgjati) dorën diku. I kërkoi (i lyp) dorën. vjet. e kërkoi për grua. I shkau (i vajti) dora padashur. Prek (fërkon, kap, zë, merr, ngre) me dorë. Përshëndet me dorë. E kapi për dore. E shtrëngon (e tërheq) me një dorë. E shtyu me të dyja duart. Ia bën me dorë diku e përshëndet me dorë. Ia mori nga duart. I shkoi dorën përsipër. Kap (shtrëngon) kokën me duar. Merr (mban) fëmijën në duar. I shpëtoi (i shkau) pjata nga dora (nga duart). Hedh e pret ndër duar. E ka shkruar me dorën e vet. Ishin kapur (ishin zënë) dorë për dorë (dorë më dorë).*

Akademiku Jani Thomai e sheh sintagmatikën ilustruese si pjesë përbërëse të mikrostrukturës kuptimore të një fjale në fjalor dhe shkruan se “Mikrostruktura e fjalorit është ndërtimi i çdo njësie leksikografike veças, ç’përmban ai që quhet “zë leksikografik” a “paragrafi i fjalës”, d.m.th. paragrafi për një fjalë a për një njësi frazeologjike. Edhe mikrostruktura varet nga tipi e nga synimi kryesor i fjalorit: në një fjalor të madh, që ka shumë fjalë, ka edhe zberthim më të imët të përmbajtjes leksikore për çdo fjalë, shpjegime më të gjera për çdo kuptim, më shumë shënime plotësuese, më shumë thënie a shembuj etj.; në një fjalor të vogël, përkundrazi, që ka më pak fjalë, ka edhe më pak kuptime për çdo fjalë, shpjegimet janë më të shkurtra, jepen më pak shënime plotësuese, thënie e shembuj etj.”³

Në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* shkruhet se “Kuptimet e fjalëve dëshmojnë me thënie, që plotësojnë a sqarojnë më mirë shpjegimet e fjalëve, tregojnë lidhjet e mënyrën e përdorimit të tyre etj. Ato renditen sipas kuptimit e ndërtimit: p.sh. tek emrat më parë vihen thëniet që shënojnë llojet e sendit a të dukurisë dhe që janë zakonisht **emër + mbijemër** (si *bota bimore, çorape të leshta, bar i njomë, pjatë e nderë, fill i dredhur* etj.), thëniet **emër + emër** (si *qumësht lope, fletë nderi, mish viçi, vaj ulliri, fole milingonash, gotë rakie, kripë gjelle, sapun rrobash*

³ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2008, f. 308.

etj.) dhe thënie **emër + parafjale + emër** (si *gjalpë pa kripë, këpucë me qafa, rrobaqepësi për gra* etj.). Pastaj vijnë thënie për pjesët e sendit ose për veprimet që lidhen me të dhe që zakonisht përbëhen nga **emër + fjala e shpjeguar** (si *dorëza e parmendës, halat e grurit, gryka e pusit* etj.), thënie me marrëdhënie kundrinore që përbëhen nga **folje + emër** (si *preu dru, ndez zjarrin* etj.). Si thënie janë vënë edhe disa njësi frazeologjike ose fjalë të urta që lidhen drejtpërdrejt me kuptimin përkatës. Në raste të tilla shpjegimi i kuptimit plotësohet zakonisht me shënimin (edhe në një varg njësisht frazeologjike). Më rrallë janë vënë si thënie fjali të plota, vargje të shkëputura ose pjesë nga dialogë, që jepen në mes dy katrorësh: p.sh. *Kriza është bashkudhëtare e pashmangshme e kapitalizmit* (te **bashkudhëtar/e, ~ja**). *Ky i bekuar shi i prishi të lashtat* (te **bekuar (i,e)**). - *Nesër do të shkosh?* - *E, nesër.* - *Japim gjithçka për mbrojtjen e vendit tonë socialist. Dhe jetën.*"

Fjalorët shpjegues të shqipes të botuar pas këtij fjalori ndjekin të njëjtin model për dhënien e sintagmatikës ilustruese, dukuri që transmetohet edhe te hartimi i fjalorëve dy gjuhësh nga autorë shqiptarë e veçanërisht kur shqipja është gjuhë e parë.

Me problemin e sintagmatikës ilustruese në një fjalor shpjegues është marrë edhe akademiku Androkli Kostallari. Në artikullin *Parimet themelore për hartimin e "Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe"*, ai parashtron problemet që mund dilnin në hartimin e një vepre të tillë, si: *zgjedhja e fjalëve (përbërja e fjalësit); frazeologjia dhe ilustrimet në fjalor; struktura e fjalorit dhe struktura e artikullit për çdo fjalë; homonimet; zërbërthimi i shpjegimi i kuptimeve të fjalëve; pasqyrimi i veçorive stilistikore të fjalëve; karakteristika gramatikore të fjalëve; njohuritë etimologjike në fjalor; çështje të drejtshkrimit; problemi i theksit*".⁴

Kur ky studiues ndalet te *Struktura e artikullit për çdo fjalë*, shkruan se "Pas shënimeve gramatikore e stilistikore jepet shpjegimi i kuptimit ai i kuptimeve të fjalës, *bashkë me shembujt ilustrues, thinjet e bashkimet frazeologjike që lidhen pak a shumë me njërin apo tjetrin kuptim.*"⁵

Sipas akademikut "*Përkufizimet e kuptimeve dhe të ngjyimeve kuptimore të fjalëve shoqërohen rregullisht e vërtetohen me material ilustrues* (citate dhe thënie)... *Shembujt ilustrues ndihmojnë për zbulimin*

⁴ A. Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e "Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe"*, në "Studime mbi...", II, Tiranë, 1972, f. 16.

⁵ A. Kostallari, *Po aty*, f. 51.

më të plotë të kuptimit dhe shërbejnë si mjet plotësues për karakterizimin e fjalës, duke treguar sferën e përdorimit, rrethimin tipik leksiko-gramatikor, vërtetojnë vlerësimin stilistikor dhe karakteristikën gramatikore që i jepet fjalës. Këtij parimi të përgjithshëm duhet t'i nënshtrohet edhe frazeologjia, kur ajo mund të kryejë funksione të tilla.”⁶

Sipas A. Kostallarit “Thëniet më të përdorshme, do të jenë togje dy – tri fjalësh, si:

Emër + mbiemër: cilësi racore, shoqëri sportive, marrëdhënie shtetërore, gjalpë i njomë, vend malor, marrëdhënie bashkëshortore, bota bimore, rrugë pyjore, qëndrim parimor, luftë e drejtë, pritje e ngrohtë etj.

Emër + emër: flluskë sapuni, lëng portokalli, qumësht lope, mish viçi, dhjam derri, dru ahu, lugë gjelle, gotë uji, filxhan çaji etj.

Emër + emër të prirë nga një parafrjalë: sallatë me ullinj, byrekë me petë, lakror me presh, mish me patate, gjalpë pa kripë, rregullore mbi të drejtat e autorit etj.

Folje + emër: pres gishtin, pres dru, pres biletën, pres miq, pres vëllanë; shkel gazin, shkel rregullat; vras dorën, vras një lepur etj.;

Folje + ndajfolje ose lokucion ndajfoljor: shkoj shpejt, shkruaj bukur, flas shtruar, sillem mirë, vij rrotull, shkoj kaluar, shkoj më këmbë, bie në fund, punoj me zell, ha me (pa) shije.

Folje + folje: bie të fle, filloj të flas, i jap të kuptojë, e bëj të dërsijë etj. etj.”⁷

Me sintagmatikën ilustruese është marrë dhe akademiku Jani Thomai, i cili shkruan se “Ilustrimet në fjalorë janë dy llojesh: *grafike*, si fotografi, harta e skica (kryesisht në fjalorët enciklopedikë, ideografikë etj.) dhe *gjuhësore*, si thënie (togje fjalësh) dhe shembuj të plotë (fjali). Në fjalorët shpjegues përdoren zakonisht ilustrimet e llojit të dytë.”⁸ Pra në fjalorët gjuhësorë sipas këtij studiuesi përdoren *thënie* si togje fjalësh, si sintagma të vetëqëndrueshme, por të shkëputura nga përdorimi konkret. Ato më shumë janë ndërtime modelore nga hartuesit sipas mundësive valencore të fjalës që ilustrojnë. Akademiku shkruan se “*Thëniet* janë togje të shkurtra fjalësh, që vihen pas shpjegimit të një kuptimi, për ta plotësuar atë me elemente e nuanca më të imëta të atij kuptimi, të cilat nuk mund të jepen të gjitha në shpjegim. Por thëniet kanë edhe vlera të tjera plotësuese në nuancat shprehëse, emocionuese e stilistike, në llojet e

⁶ A. Kostallari, *Po aty*, f. 45-46.

⁷ A. Kostallari, *Po aty* f. 46-47.

⁸ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2008, f. 315.

lidhjeve sintaksore të fjalës që shpjegohet, në fushën leksikore dhe në gjithë *leksematikën a sintagmatikën* e saj. Thëniet tregojnë që kjo fjalë në këtë kuptim është reale në gjuhë dhe ka këtë fushë e këto veçori përdorimi. Po japim vetëm dy shembuj: *dru-ja f. sh. -, -të* “1. trung ose degë druri; pjesë e prerë nga druri, që përdoret për t’u djegur, për ndërtim etj.; hu, dajak, kopaçe (edhe *fig.*): *dru i thatë (i njomë)*; *dru të prera (të thata, të çara, të shkurtra)*; *dru dushku (shkoze, ahu)*; *një krah (një barrë) dru*; *stavë drush*; *hëngri dru* e rrahu keq dikush; *e shtroi në dru* e rrahu shumë...”; *kuq (i), -e (e) mb.* “... 3. pjesë e dytë e emërtimeve të pathjeshta të disa bimëve, të kafshëve etj., që e kanë ngjyrën si ajo e gjakut: *krimbi i kuq (zool.)*; *morri i kuq (zool.)*; *merimanga e kuqe (zool.)*; *trëndafili i kuq (bot.)*; *panxhari i kuq (bot.)*; *kumbulla e kuqe (bot.)*...”.⁹

Gjithashtu akademiku J. Thomai shkruan se *sintagmatikën* e krijojnë edhe shembujt. Ata i gjejnë zakonisht në fjalorët e tipit të madh, shumëvëllimësh, si dhe në fjalorë tematikë (në fjalorë autorësh, veprash, konkordancash etj.). ai shkruan se “Shembujt gjithashtu shërbejnë për të plotësuar shpjegimin e kuptimit me nuanca të holla semantike, emocionuese, shprehëse, stilistike, të përdorimit etj., por, më shumë se thëniet, ato japin edhe bukurinë e shprehjeve me këtë fjalë, jetën e saj të gjallë në ligjërimi të ndryshme. Shembujt nxirren nga të gjitha gjinitë e gjuhës së shkruar e të folur: nga letërsia artistike, shkencore, mësimore, nga publicistika, nga folklori, nga ligjërimet e folura popullore etj. Me këtë funksion vihen edhe proverbat e fjalët e urta. Janë fjali të zgjedhura mirë, nga shkrime të mjeshtërive të gjuhës, sa më të rregullta jo vetëm nga ana e ndërtimit gjuhësor, në përputhje me natyrën e shqipes, por edhe nga përmbajtja e nga “estetika” e shprehjes, nëpërmjet të cilave lexuesi fiton vlera të reja për fjalën dhe ndien bukurinë e forcën e gjuhës. Shembujt shoqërohen me burimin e tyre (autori, vepra, gazeta etj.) për të krijuar ndjenjën e sigurisë së përdorimit të fjalës në kontekstin e dhënë. Shembujt vihen zakonisht në fjalorë shpjegues të mëdhenj, por edhe në fjalorë të mesëm.”¹⁰

Për këtë studiu, sintagmatika përfshin edhe njësitë frazeologjike, por jo rrallë edhe fjalë të urta, fjalë fluturake e proverba. Ai shkruan se “Me vlerë shënuese e ilustruese njëherazi në fjalorët shpjegues vihet edhe *frazeologjia gjuhësore*, e grupuar në një kuptim të veçantë, kur lidhet në elementet themelore të kuptimit, ose në fund të strukturës kuptimore të

⁹ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2008, f. 315-316.

¹⁰ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2008, f. 316.

fjalës, pas një shenje të posaçme (yllth, katrorth...); p.sh *bíe jokal.*, *ráshë*, *rëñë* "... 13. edhe *fig.*, ndodhem papritur në disa rrethana a në një gjendje të caktuar; hyj, futem; ... (edhe në njësi frazeologjike): *ra në grackë* (në *kurth*); *ra në hall* (në *bela*); *ra ngushtë* (*keq*); *ra në thonjtë* (e dikujt); *ra në mendime* (të *thella*); *ra në gjumë* (në *klapi*); *ra në dashuri*; *më ranë veshët rehat* (*bised.*); *ra në familje të mirë*... **bjeri t'i biem*; *ra brenda*; *i ra bretku*; *i ra në bri*; *ka rënë nga dega*; *më ra në dorë*; *ra nga fiku*; *i kanë rënë dhëmbët*; *i ra në gjurmë*; *më ra gjuha* (*përtokë*); *ra nga kali*; *më ranë këmbët*; *i ra mendjes*; *i ranë pendët*; *i ra pikës*; *më ra në qafë*; *ka rënë nga qielli*; *bie në sy*; *i ra me top*; *ku rafsha mos u vrafsha*...."¹¹

Kurse tudiuesi Hajri Shehu është leksikografi i parë që përdor në mënyrë sistimore dhe shkencore termin *sintagmatikë*, duke ffilluar, saktësuar, zgjeruar dhe plotësuar konceptin e paraqitur nga akademiku Jani Thomai. Madje ai përdor tre terma për nocionin e sintagmatikës leksikografike ilustruese: *sintagmatikë*, *shembullsim*, *bashkëlidhje leksikore e fjalëve*.¹² Ndër të tjera ai shkruan për rëndësinë e sintagmatikës në një fjalor dhe thekson se thëniet ilustruese në një fjalor janë nocion leksikologjik e leksikografik dhe nuk duhen ngatërruar me përdorimin e tyre në një thënie të shkëputur nga një ligjërimi i caktuar. Ato kanë karakter përgjithësues. Ai shkruan se "Sintagmatika në një fjalor mund të kalohet si pa u vënë re, sepse, duket, konsiderohet si më pak e rëndësishme se shpjegimet a përkufizimet ose se barasvlerësit (kur fjalori është dygjuhësh), çka mund të jetë e vërtetë, ose sepse mund të mendohet që puna e leksikografit zë më pak vend në të, çka nuk është e vërtetë. Natyrisht, sintagmat a togfjalëshat, si një nga llojet e frazës, sipas kuptimit sosyrian, ose thëniet, sipas metagjuhës sonë leksikografike, nuk mund të zënë vendin e analizës semantike në një fjalor; leksikografi nuk mund të kërkojë nga përdoruesi i fjalorit që t'i analizojë thëniet dhe të mësojë prej tyre atë që nuk përshkruhet, nuk shpjegohet a nuk përkufizohet qartë. Por, nëse, p. sh., nuk thuhet dot në shpjegim se aksh folje a mbiemër mund të lidhet me fjalë që shënojnë objekte të gjalla ose të pagjalla, atëherë përdoruesi mund të shohë shembujt ilustrues (*u ftoh moti* / *u ftoh nga shokët*; *dhomë e ftohtë* / *njeri i ftohtë*; *ecën njeriu* (*kali*) / *ecën koha* (*ecën puna*). Sigurisht, thëniet nuk mund të konsiderohen nivel i pavarur i

¹¹ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2008, f. 316-317.

¹² H. Shehu, *Çështje të sintagmatikës në fjalorë të shqipes*, në Konferencën shkencore ndërkombëtare "Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë", Tiranë, 2005.

gjuhës; ato janë njësi ndërtimore të ligjërit, lëndë ilustruese për fjalorin e brenda kësaj hullie ato janë nocion gjuhësor, dhe veçmas nocion leksikologjik e leksikografik.¹³

Në vazhdim ai, pasi fillon konceptin *sintagmatikë ilustruese leksikografike* ose sipas tij *shembullsimi në fjalor, ilustrimi i glosës me shembull, fjala bashkë me fjalën*, shkruan se “Shembullsimi në fjalor, ilustrimi i glosës me shembull, fjala bashkë me fjalën është njëra nga tri teknikat leksikografike (të tjerat janë: shpjegimi, në kuptimin e gjerë të fjalës në leksikografi, dhe barasvlerësimi në fjalorë dygjuhësh). Ne e kuptojmë gjerë ilustrimin: *fjalorët kanë nevojë për ekologjinë e fjalëve, domethënë, për ndërlidhjet kontekstuale, për bashkëlidhjet e zakonshme të fjalëve.*”¹⁴

Ai jep në vazhdim shkurt disa argumente. Sipas këtij studiuesi, bashkëlidhja është më se e domosdoshme dhe ka natyrë jashtëgjuhësore. Ai shkruan se “*Bashkëlidhja leksikore e fjalëve* përcaktohet nga faktorë jashtëgjuhësorë, nga lidhjet sendore-logjike që ekzistojnë në veprimtarinë reale ndërmjet sendeve dhe dukurive që shënohen nga fjalët (shih p. sh. togfjalësha që kanë të bëjnë me grupin tematik të njerëzve sipas dukës a tipareve morale: thuhet *i ka sytë të larmë*, por jo *i ka vetullat të larme*; thuhet *ka gojë të ëmbël*, por nuk thuhet *ka dhëmbë të ëmbël*). Kjo rregullsi mund të quhej ligji i valencës dhe leksikografi nuk mund t’u shmanget ligjeve.”¹⁵

Sipas tij, “Valenca është bashkëlidhje potenciale e njërive gjuhësore, domethënë mundësi e tyre për t’u bashkëlidhur në ligjërime sipas sistemit të gjuhës...Gramatikisht, mundësia për të krijuar bashkëlidhje kushtëzohet nga valenca e pjesëve të ligjëratës. Përkatësia në këtë a atë pjesë të ligjëratës kushtëzon mundësinë, gjerësinë dhe strukturën e bashkëlidhjeve të fjalëve; p. sh., siç dihet, folja bashkëlidhet thuajse pa kufizim me ndajfolje; emri, me emër dhe me mbiemër etj.”¹⁶

Madje studiuesi Hajri Shehu na e jep me hollësi pasqyrën e këtyre valencave:

Valenca e emrit:

emër + emër (*vend banimi, fundi i javës, bërës vozash, gjë pa rëndësi, zell për punë etj.*)

¹³ H. Shehu, *Po aty*, f. 167.

¹⁴ H. Shehu, *Po aty*, f. 168.

¹⁵ H. Shehu, *Po aty*, f. 168.

¹⁶ H. Shehu, *Po aty*, f. 188-169.

Sintagmatika ilustruese në leksikografi

emër + mbiemër (*flok i verdhë, fjalë e ëmbël*)
emër + ndajfolje (*me kokë poshtë*)
numëror + emër (*dy kate*)
emër + përemër / përemër + emër (*me dashjen e vet, disa ballë*)
folje + emër (*shkruaj letër, i shkruaj vëllait*)
emër + folje (paskajore) (*dëshira për të fituar*)

Valenca e mbiemrit:

mbiemër + mbiemër (*ekonomik e shoqëror*)
mbiemër + emër (*i madh nga mosha; i drejtë si plep; i paaftë për punë*)

emër + mbiemër (*gjethe e verdhë*)
ndajfolje + mbiemër (*shumë i madh*)
mbiemër + folje (paskajore) (*i paaftë për të punuar*)
përemër + mbiemër (*diçka rastësore*)

Valenca e numërorit:

numëror + emër (*dy anë; tre nga shokët*)

Valenca e përemrit:

përemër + emër / emër + përemër (*diçka me vlerë; me bindjen e vet*)
përemër + përemër (*secila nga ju*)
përemër + mbiemër (*ka diçka të mirë*)
përemër + folje (paskajore) (*diçka për të ngrënë*)

Valenca e foljes:

folje + emër (*shoh fushën, ngul këmbë*)
emër + folje (paskajore) (*zell për të punuar*)
folje + folje : paskajore, përcjellore, formë e pashtjelluar mohore (*erdhi për të pyetur; ecte duke fishkëllyer; hyri pa trokitur*)
folje + ndajfolje (*flet qartë, çoj tej, hedh poshtë etj.*)

Valenca e ndajfoljes:

folje + ndajfolje (*pres mirë, flas shkurt*)
ndajfolje + ndajfolje (*mjaft larg, shumë bukur*)
ndajfolje + mbiemër (*mjaft i dobët*)
emër + ndajfolje (*malit përtpjetë*)¹⁷

Sipas këtij studiuesi, dhënia e sintagmatikës ilustruese në fjalor është e përligjur shkencërisht, sepse informacionin fjala e transmeton vetëm në lidhje me fjalët e tjera, në thënie e në përdorime të caktuara. Për të argumentuar këtë, ai sjell dhe mendimin e studiuesve të njohur botërorë.

¹⁷ H. Shehu, *Po aty*, f. 168-169.

Ai shkruan se “Jashtë kontekstit, jashtë përkatësisë sendore-nocionore konkrete fjala sjell informacion të papërcaktuar dhe ka vetëm kuptim potencial. Ajo e merr plotësisht kuptimin e saj real, si të thuash semantizohet në një kontekst a situatë të caktuar, ku asnjësohen disa përbërës të saj kuptimorë e aktualizohen disa të tjerë. Në këtë aspekt, kuptimi është rezultat i bashkëlidhjes së fjalës me mjedisin rrethues [shih, p. sh., **mjegull** *dyshimi*, **zemra** *e tokës*, **shpatulla** *e malit*, **njeri i shkueshëm**, **dhomë** *e errët*, **mendim** *i errët* / **regjim** *i errët*; krahaso: **shartoj** *mollën* dhe **shartoj** *çorapet*; të nxehtë mbërriti 37 **shkallë** dhe **shkalla** *e lartë do këmbë të forta* etj.; në qoftë se *u çmend / u tërbua / u marros / u ndërkrue / shkalloi* nuk do të vihej pas *saj / pas tij*, nuk do të kishim kuptimin “e do jashtë mase dikë a diçka”, por kuptimin konkret “humbi aftësinë për të menduar, u sëmur nga mendja”; te mbiemrat marrëdhëniesorë, tipari cilësor mund të dallohet vetëm (ose kryesisht) nga konteksti; krahaso p. sh. *fustan i mëndafshhtë* dhe *flokë i mëndafshhtë*: 1. “i butë si mëndafshi” dhe 2. “i ndritshëm si mëndafshi”]. Në mënyrë të veçantë, kuptimet e foljes shumëkuptimëshe varen nga mjedisi rrethues, nga emrat me të cilët bashkëlidhen; krahaso: **shtroj** *drekën* / **shtroi** *një drekë* / **shtroi** *të shoqen në spital* / e **shtroi** *për diskutim* / **shtroj** *makinën* / **shtroi** *dy pula* “vuri kllonka dy pula” / **shtroi** *speca (domate)* “vuri turshi speca (domate)” etj. Midis përmbajtjes së brendshme të fjalës (në këta shembuj) dhe përdorimit të saj në ligjërim, domethënë, midis kuptimit të saj dhe ndajshimit të saj të fjala tjetër, në togfjalësh ka një lidhje ligjësores të domosdoshme. Kjo lidhje tregon pa dykuptimësi se cila është përmbajtja e fjalës ose, siç thotë L. Vitgenshtein, *ajo që nuk mund të shprehet në shenjë, shfaqet në përdorimin e saj*. E, leksikografi është i detyruar ta japë përmbajtjen e fjalës pa dykuptimësi, ta pasqyrojë atë që quhet aktualizim i njëjësive leksikore.”¹⁸

Në linjën e argumentimit të dosmosdoshmërisë së dhënies së sintagmatikës ilustruese leksikografike përmes thënieve, studiuesi Hajri Shehu sqaron dhe natyrën e kësaj sintagmatike të lidhur me llojin e fjalorëve. Ai shkruan se “Thëniet kanë të bëjnë me aspektin aktiv të leksikut, në kuptimin e gjerë të fjalës. Si në gramatikë, edhe në leksikologji e leksikografi mund të flitet për dy rrafshë leksikore të gjuhës – rrafshi semasiologjik dhe rrafshi onomasiologjik. I pari ka të bëjë me tingëllimin, formën dhe kuptimin e fjalës. I dyti ka të bëjë me fjalët dhe shprehjet që janë në gjuhë, për të përcjellë këtë a atë nocion. E thënë ndryshe, kjo ka të

¹⁸ H. Shehu, *Po aty*, f. 170.

bëjë me informacionin që jep folësi a shkruesi dhe me marrjen e informacionit nga dëgjuesi a lexuesi në procesin e kodifikimit dhe të dekodifikimit të kumtimit. Pa e shkëputur kursesi ciklin folës-dëgjues a shkrues-lexues, duhet thënë se të dy e gjejnë veten në fjalorë (të tipave të ndryshëm). Një fjalor shpjegues, p. sh., ua plotëson kërkesën për të marrë informacion. Por, sa ua plotëson kërkesën një fjalor i tillë a aksh fjalor në përgjithësi, për të zgjedhur fjalët e nevojshme për ligjërim? Këtë detyrë mund ta plotësojë fjalori i thënieve (edhe i sinonimeve etj.), domethënë, një fjalor, i nevojshëm, kur kodojmë, kur kryhet kalimi i shenjuar – shenjë. Detyra themelore e këtyre fjalorëve është përshkrimi i mjeteve gjuhësore efektive për shprehjen e nocioneve (paradigma semantike, mikrofusha semantike etj.) ose *përshkrimi i përdorimit të fjalëve dhe i lidhjeve të tyre me njëra-tjetrën* (sintagmatika formale dhe semantike), ose të dyja njëherësh. Njëra nga këto detyra, e dyta, ka të bëjë thelbësisht me togfjalëshat ilustrues në fjalor.¹⁹

Studiuesi H. Shehu ndalet gjerësisht te vlerat dhe funksioni i thënieve si përbërëse të sintagmatikës ilustruese leksikografike. Ai shkruan se “Në një vështrim gjuhësor e veçmas leksikologjik e leksikografik më specifik përmendim: thëniet **kanë vlerë denotative** (*elektrodë pozitive* është “anodë”, *elektrodë negative* është “katodë”, *puçërr e zezë* është “plasja”; në anglishte *gërshërë delesh* është “shears” e të *kuq buzësh* është “lipstick”); **kanë vlerë konotative** (shih p. sh. kuptimet e kushtëzuara sintaksore, që lindin veçse në një kontekst të caktuar: tipi *është dhëlpër ai* etj.); **thëniet diferencojnë kuptimet e fjalëve shumëkuptimshë** (*rini entuziaste* është “rini që punon me entuziazëm” / *këngë entuziaste* është “këngë që shpreh entuziazëm”; *zë i frikshëm* “të shtie frikën” / *njeri i frikshëm* është “njeri frikacak”); **saktësojnë kuptimet e kryehershme** (*nxit zjarrin* “i fryj që të ndizet”; *kallëzuan grunjërat* “nxorën kallëzit”; *kur shporta ka fiq, gjithë jetën e ke miq*); **saktësojnë ngjyrimet kuptimore të sinonimeve** (krahaso ndajfoljet *shumë* e *tepër*); **plotësojnë informacionin që jepet në shpjegimin e glosës** (*zvarranikët pjellin vezë*); **motivojnë regjistrat shkencorë të njësive leksikore a të kuptimeve të tyre** (krahaso *pika e vlimit* dhe *vëmë pikë në fund të fjalisë*); **ilustrojnë njësitë e çerdhes fjalëformuese** (krahaso *mish pa kocka s’ka* dhe *ind kockor*; *mbuloj supet me shall* dhe *mbulesa e tryezës / me fytyrë* të mbuluar; *natë* e *pagjumë* dhe *vuan nga pagjumësia*; *pluhur qymyri* dhe *pluhurzojnë qymyrin* etj.); **tek emrat prejfoljorë, thëniet shërbejnë për**

¹⁹ H. Shehu, *Po aty*, f. 170-171.

të dalluar veprimin, gjendjen, rezultatin (*gjetje te gjetja e xeherorit* është veprim; *tek është një gjetje e bukur* “zgjedhje e mirë” e *te gjetje të reja arkeologjike* “sendet që zbulohen gjatë gërmimeve” *gjetje* shënon rezultat; *te gjelbërim i rrugëve* shënohet veprimi; *te u mbush me gjelbërim* shënohet rezultati, “bimësia”; *tek tërheqja dhe sulmi* (si taktikë ushtarake) *tërheqja* është veprim dhe rrjedhim; *therje te bagëti për therje* është veprim; *te kam therje në shpatull* është rezultat, “thermë”); **motivojnë vlerat stilistike të fjalëve a të kuptimeve të tyre** (krahaso *njom pambukun* dhe *e njomi me pështymë* / për dikë, që i dalin cërkat e pështymës kur flet; *e hëngri bukën* dhe *e hëngri të shkretën vajzë*; *ka sy të sormë* dhe *ka sy sorrush* etj.) dhe **tregojnë nivelin stilistik të përdorimit** (dhe fjalori e ka për detyrë të japë informacion stilistik); **veçojnë homonimet** (erë_I e *butë* është “juga” / erë_{II} e *mirë* është “ajo që ndihet me hundë”; *te ndizte zjarr me erëza*, “erëzat” janë “bajga të thata”; *te gatesat duan erëza*, *erëzat* janë “bimë të merme” etj.); **dallojnë paronimet** (krahaso *kryetari i bashkisë* dhe *kryetari i bashkësisë*; *njeri i ndershëm* dhe *njeri i nderuar*); **veçojnë njësitë paronomazike** (krahaso *muzikë shekullare* dhe *muzikë shekullore*; *mëshiroj të varfrit* dhe *dashurinë për të varfrit e mishëron në poezinë e tij*); **mbështesin dhe plotësojnë barasvlerësit në një fjalor dygjuhësh** (krahaso, p. sh. *sapun i butë* “soft soap” dhe *klimë e butë* “mild climate”) etj.²⁰

Në vijim nga *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe* ilustrim po sjellim shembuj nga sintagmatika ilustruese, e cila, siç u tha, ka të bëjë me ilustrimin e kuptimeve me thënie (me togfjalësha, sintagma dy-, tregjymtyrëshe, me fjali të përgjithësuara, me fjalë të urta, me njësi frazeologjike apo edhe me emërtime të pathjeshta). Si sintagma ilustruese përdoren dhe fjali me kontekst të përcaktuar (të shkëputura nga një tekst i dhënë), përdoren diagrama, fotografi, skica, vizatime etj. le t’i shohim konkretisht.

a. Ilustrime më thënie / sintagma me emra: GJÚH/Ë,~A f sh. ~Ë, ~ËT. 2. Një sistem i tillë, që është krijuar e zhvilluar historikisht nga një popull dhe që përbën një nga tiparet themelore të një kombësie a të një kombi. *Gjuha shqipe. Gjuha frënge (greke, angleze). Gjuha amtare. Gjuha letrare kombëtare. Gjuhë e huaj. Gjuhë e gjallë (e vdekur). Gjuhët e lashta. Gjuha e sotme. Gjuhët indoevropiane. Gjuhë të afërta. Familje (grup) gjuhësh. Pastërtia e gjuhës. Fjalori i gjuhës shqipe.*

²⁰ H. Shehu, *Po aty*, f. 167, f. 174-175.

b. Ilustrime më thënie / sintagma: GJE/J kal., ~TA, ~TUR. 1. Zbuloj diçka a dikë që ka humbur ose është zhdukur, fshehur a mbuluar; *kund. humb, humbas. E gjeti librin. E gjetën fëmijën. E gjeti poshtë shtratit (pas raftit). Mezi e gjeta. E kërkova, po s'e gjeta. Gjej rrugën nëpër errësirë.*

c. Ilustrime më thënie / sintagma me mbiemra: FTOHTË (i,e) *mb. 1.* Që ka temperaturë të ulët, që ka ftohtësi; *kund. i ngrohtë; i nxehtë. Ujë (ajër) i ftohtë. Rrymë e ftohtë. Tokë e ftohtë. Është i ftohtë.*

d. Ilustrime më thënie / sintagma ndajfoljore: BÛTË ndajf. 1. Pa e vrarë e pa e gërvishtur, ngadalë e lehtë; ëmbël, si me përkëdheli, pa e përplasur me forcë; pa kundërveprim të fortë, si në gjë të butë; lehtë e pa u thyer; *kund. ashpër; fort. Prek (fërkoj) butë. Godit (qëlloj) butë. Bie butë (dëbora). Shkruan butë (lapsi). E bluan butë (miellin). Shkel butë (në baltë) shkel në të butë. Bie butë bie në të butë (në krevat a në dyshek të butë).*

e. Ilustrime më thënie / sintagma parafjalore ME. I. parafj. Përdoret me një emër ose me një përemër në rasën kallëzore për të treguar: **1.** Praninë e dy a më shumë vetave a sendeve së bashku në një vend, qenien e tyre së bashku në një gjendje të caktuar ose pjesëmarrjen e tyre të përbashkët në një veprim; shoqërimin e dikujt a të diçkaje nga dikush a diçka tjetër kur ndodhet në një gjendje të caktuar ose kur kryen një veprim. *Motra me vëllanë janë në një klasë. Rri gjithnjë me të. Jetonte me fëmijët. Është i një mendjeje me shokët. Luan me shokët e klasës. Shkon mirë me të gjithë. Foli (bisedoi) me miqtë. U takua me miqtë. U zu (u pajtua) me të tjerët. Marrin e japin me njëri-tjetrin. E mori me vete. Doli shëtitje me prindërit. Eja me mua! E shoqërojnë misrin me fa-sule. Ra me zhurmë të madhe.*

f. Ilustrime me fjali. Në fjalorët shpjegues që ka shqipja në përdorim nuk mungojnë shembujt me fjali. Por këto fjali nuk janë shkëputur nga tekste të ndryshme ose nga ligjërime të folura. Ato janë ndërtime sintagmatike me vlerë të përgjithshme, duke nënkuptuar marrëdhënien gjuhë – ligjërime, por jo një akt i vërtetë komunikimi, me folës e dëgjues konkret. Në këtë rast marrësi i mesazhit është secili prej përdoruesit të fjalorit. Nga *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, po japim një kuptim nga folja **MEND/ÓJ jokal., ~ÓVA, ~ÚAR. 1.** Kam aftë-sinë të gjykoj, të arsyetoj, të formoj një mendim etj.; bie në mendime, vras mendjen, mendohem; edhe *kal.* rrah diçka me mend, arsyetoj për një gjë dhe përpiqem me mend të zbuloj thelbin e lidhjet e saj, ta kuptoj, ta zgjidh etj.; gjykoj. *Njeriu mendon. Kur nuk flet, mendon. E mendoj thellë punën.*

Mendon drejt. Mendo mirë! Mendo për këto që të thashë. Rri e mendoj... S'mendoj më gjatë. Na ka bërë të mendojmë. Mendo dhjetë herë e fol një herë. fj. u.

Mjet tjetër për ilustrimet janë dhe diagramat, fotot, hartat, skicat etj. Në përgjithësi këto përdoren kur hartohen fjalorë enciklopedikë. Por nuk mungojnë dhe në fjalorët e përgjithshëm. Në anglishte, frëngjisht, italishte etj., kjo është një dukuri e njohur dhe teknikat leksikografike gërshetohen me ato enciklopedike.

Si përfundim, sintagmatika ilustruese në një fjalor është element më se i domosdoshëm. Kjo vërehet sidomos në fjalorët shpjegues, në të cilët thëniet ilustruese jo vetëm tregojnë jetën e fjalës së shpjeguar në një sintagmë, por dhe ndihmojnë në fillimin e kuptimit si dhe shpesh herë plotësojnë shpjegimin e këtij kuptimi. Sintagmatika ilustruese është element i pranishëm dhe në fjalorët dygjuhësh, duke luajtur rol të pazëvendësueshëm në nxjerrjen e saktë të kuptimit të fjalës së përkthyer (të barasvlerësit të një fjale në gjuhën e dytë të fjalorit). Kjo ndihmon shumë këdo, por sidomos lehtëson në mënyrë të dukshme punën e mësuesit të gjuhëve të huaja në orën e mësimit dhe nxënësin në përvetësimin e pasurisë leksikore e të strukturës gramatikore të gjuhës së huaj.